



This programme is funded  
by the European Union



**MNE-ALB**

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME  
MONTENEGRO – ALBANIA 2014–2020



Ministarstvo  
regionalno-investicionog  
razvoja i saradnje sa  
nevladinim organizacijama

# **MANUAL GRANTESH**

## **SKEMA E FINANCIMIT TË PLANEVE TË BIZNESIT NË PROJEKTIN**

**Women microenterprise development in the  
cross-border area**

**Kontrata nr: CFCU/MNE/284**

**28 Janar 2026**



monitoring  
**MogUL**  
group





This programme is funded  
by the European Union



**MNE-ALB**

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME  
MONTENEGRO – ALBANIA 2014–2020



Ministarstvo  
regionalno-investicionog  
razvoja i saradnje sa  
nevladinim organizacijama

## Përmbajtja

|                                                           |    |
|-----------------------------------------------------------|----|
| Përmbajtja.....                                           | 1  |
| Shkurtesat.....                                           | 2  |
| Hyrje - prezantimi i projektit.....                       | 3  |
| 1 KRITERET E PËRFITIMIT TË GRANTIT.....                   | 5  |
| 2 KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANUESHMËRISË .....         | 5  |
| 3 KRITERET SPECIFIKE TË PRANUESHMËRISË.....               | 6  |
| 4 SHPENZIMET E PRANUESHME .....                           | 7  |
| 5 SHPENZIMET E PAPANUESHME .....                          | 8  |
| 6. MËNYRA E APLIKIMIT, AFATET DHE PROCEDURA .....         | 9  |
| 7 AUTORIZIMI DHE PEZULLIMI I SHPENZIMEVE TË GRANTIT ..... | 12 |
| 8 MONITORIMI I GRANTIT DHE RAPORTIMI .....                | 12 |
| 9 LISTA E DOKUMENTEVE TË NEVOJSHME PËR APLIKIM .....      | 13 |
| 10 KRITERET E RËNDITJES .....                             | 14 |
| 11. AFATI DHE MËNYRA E DORËZIMIT.....                     | 15 |
| 12. KALENDARI I AKTIVITETEVE .....                        | 15 |
| SHTOJCAT.....                                             | •  |
| SHTOJCA 1/1 .....                                         | •  |
| SHTOJCA 1/2 .....                                         | •  |
| SHTOJCA 2 .....                                           | •  |
| SHTOJCA 3 .....                                           | •  |



This programme is funded  
by the European Union



**MNE-ALB**

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME  
MONTENEGRO – ALBANIA 2014–2020



Ministarstvo  
regionalno-investicionog  
razvoja i saradnje sa  
nevladinim organizacijama

## SHKURTESAT

|               |                                     |
|---------------|-------------------------------------|
| BE            | Bashkimi Evropian                   |
| DE            | Drejtuesi Ekzekutiv                 |
| SPT           | Sekretariati i Përbashkët Teknik    |
| AK            | Autoriteti Kontraktues              |
| QKR           | Qendra Kombëtare e Regjistrimit     |
| OJQ           | Organizata jo Qeveritare            |
| IPA BNK       | IPA Bashkëpunimi ndër-kufitar       |
| CODE Partners | Consulting and development partners |
| MogUL         | Monitoring Group Ulcinj             |

## SHËNIM SHPJEGUES

Ky Manual i mbështetjes së planeve të biznesit, përcakton procedurën se si të aplikoni për grante përmes skemës së financimit të kuadër të projektit “**Women microenterprise development in the cross-border area**” Kontrata nr: **CFCU/MNE/284** i financuar nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancuar nga Ministria e Zhvillimit dhe Investimeve Rajonale dhe Bashkëpunimit me OJQ e Malit të Zi, në kuadër të programit **IPA BNK MNE-ALB**, zbatuar nga Komuna e Ulqinit, CODE Partners dhe OJQ MoGUL. Kërkesat që prezantohen në manual, aktet, marrëveshjet, praktikat operative dhe dispozitat e mbështetjes financiare do të përdoren nga kandidatet/gratë sipërmarrëse që nga aplikimi me idenë e biznesit, përgatitja e planeve të biznesit për idetë fituese, aplikimi me plane të biznesit si dhe menaxhimin dhe realizimin e planit për përfitueset e përzgjedhura.



This programme is funded  
by the European Union



**MNE-ALB**

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME  
MONTENEGRO – ALBANIA 2014–2020



Ministarstvo  
regionalno-investicionog  
razvoja i saradnje sa  
nevladinim organizacijama

## HYRJE – Prezantimi i projektit

Komuna e Ulqinit në bashkëpunim me CODE Partners dhe OJQ MoGUL zbatojnë projektin dy-vjeçar “Women microenterprise development in the cross-border area”, financuar nga Bashkimi Evropian dhe bashkë-financuar nga Ministria e Zhvillimit dhe Investimeve Rajonale dhe Bashkëpunimit me OJQ e Malit të Zi në kuadër të programit IPA BNK MNE-ALB.

Projekti synon të forcojë aftësitë sipërmarrëse të grave në zonën e projektit duke ofruar mbështetje në disa fusha, që mundësojnë ndër të tjera trajnimin e grave, shërbime konsulence, përgatitjen e planeve të biznesit dhe financimin e të paktën 12 plan-bizneseve (6 për secilin vend) të përzgjedhura, me fond nga 3,000 – 5,000 euro. Projekti aplikon një qasje me shumë palë të interesuara, duke integruar ekspertë kombëtarë, komunitetet lokale, autoritetet qendrore dhe lokale, shoqërinë civile etj.

## Ndikimi i Projektit dhe Rezultati

Ndikimi afatgjatë i projektit është të kontribuojë në zbutjen e papunësisë, integrimin e mëtejshëm të gruas në jetën shoqërore dhe ekonomike, fuqizimin e rolit të saj dhe zhvillimin socio-ekonomik të zonës së projektit.

**Qëllimi i përgjithshëm** i projektit është “Të forcojë iniciativat sipërmarrëse të grave në rajonet e Ulqinit dhe Shkodrës dhe të ofrojë zgjidhje të qëndrueshme për zhvillimin e bizneseve mikro dhe të vogla të grave në zonën ndërkufitare”.

**Qëllimi Specifik 1:** Të rriten aftësitë dhe kompetencat sipërmarrëse të grave të angazhuara në biznes;

**Qëllimi Specifik 2:** Të ofrohen shërbime mbështetëse në qendrën e biznesit dhe të promovohen gratë sipërmarrëse;

## Rezultatet e pritshme të projektit:

Aktivitetet e projektit do të kryhen për të arritur 4 rezultate të përcaktuara si më poshtë:

**Rezultati 1.1: Aftësi dhe kompetenca të përmirësuara në menaxhimin e biznesit, zbutjen e risqeve dhe qëndrimet e përgjithshme sipërmarrëse dhe vlerat e biznesit** - trajnime të grave në biznes dhe atyre që janë të gatshme të përfshihen në aktivitete ekonomike se si të drejtojnë dhe menaxhojnë një biznes, zbutjen e riskut etj.

**Rezultati 1.2: Rritje e aktivitetit ekonomik në prodhimin, tregtimin dhe shitjen e produkteve lokale** - financimi i planeve të miratuara të biznesit me qëllim mbështetjen e zgjerimit të produkteve ekzistuese të biznesit dhe fillimin e atyre të reja.

**Rezultati 2.1: Shërbime këshillimi të Qendrës së Biznesit të themeluar për gratë sipërmarrëse me qëllim rritjen e aktiviteteve ekonomike dhe zhvillimin e biznesit** - ambiente të pajisura të dedikuara për të ofruar shërbime këshillimore për gratë sipërmarrëse. Ekspertë të fushave të ndryshme që ofrojnë shërbimet financiare, ligjore etj.

**Rezultati 2.2: Oferta e biznesit të grave promovohet dhe tregtohet** - promovimi i produkteve ekzistuese dhe të reja do të ofrohet nga projekti përmes organizimit të panireve lokale dhe



This programme is funded  
by the European Union



**MNE-ALB**

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME  
MONTENEGRO – ALBANIA 2014–2020



Ministarstvo  
regionalno-investicionog  
razvoja i saradnje sa  
nevladinim organizacijama

ndërkombëtare, përgatitjes dhe shtypjes së katalogut të biznesit të grave, organizimit të konferencës së donatorëve etj.

## **Mjetet e parashikuara për mbështetje**

### **Shuma e përgjithshme**

Shuma e përgjithshme maksimale e cila parashikohet të ndahet për mbështetjen e biznes planeve për gratë sipërmarrëse në kuadër të projektit 'Women microenterprise development in the cross border area' është 60 000 Euro.

Ulqin, Mali i Zi – 30 000 Euro

Shkodër, Shqipëri – 30 000 Euro

Të gjitha mjetet që ndahen në kuadër të kësaj thirrje duhet të jenë në vlerë mes:

- Shuma minimale: 3.000
- Shuma maksimale: 5.000



This programme is funded  
by the European Union



**MNE-ALB**

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME  
MONTENEGRO – ALBANIA 2014–2020



Ministartvo  
regionalno-investicionog  
razvoja i saradnje sa  
nevladinim organizacijama

## 1. KRITERET E PËRFITIMIT TË GRANTIT

Skema e financimit të ideve/planeve të biznesit në kuadër të projektit “Women microenterprise development in the cross-border area” do të mbështesë ato iniciativa dhe biznese që operojnë në Zonën e Projektit që përfshin zonën e Komunës së Ulqinit në Mal të Zi dhe rajonin e Shkodrës, në Shqipëri.

Të drejtë aplikimi kanë gratë e regjistruara/pjesëmarrëse, të cilat kanë ndjekur programin e trajnimit në kuadër të projektit ‘Women microenterprise development in the cross border area’.

Të gjitha gratë/sipërmarrëset e regjistruara në projekt, mund të aplikojnë për të përfituar nga skema e granteve me vetëm 1 (një) ide/plan biznesi.

## 2. KRITERET E PRANUESHMËRISË

### A. Kriteret e përgjithëshme të pranueshmërisë për të gjitha aplikantët.

- Aplikantët duhet të jenë të regjistruara në projekt dhe të kenë marrë pjesë në aktivitetet e projektit
- Aplikantët mund të aplikojnë vetëm për një grant në këtë thirrje.
- Të gjitha dokumentet e paraqitura nuk duhet të jenë më të vjetra se 6 muaj (përjashtim bëjnë dokumentet nga QKR - Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe Gjykata, ku vlefshmëria duhet të jetë 30 ditë).
- Koncepti i propozuar për biznes ide/plan duhet të ndjekë formatin e dhënë sipas anekseve përkatëse.
- Aplikantët që kanë marrë pjesë në programin e trajnimit të projektit, marrin pikë shtesë për cdo ditë trajnimi që kanë ndjekur<sup>1</sup>.
- Përfituesja e grantit do të kryejë gjithmonë punën dhe veprimtarinë e vet në përputhje me të gjitha ligjet, rregulloret dhe kontratën e nënshkruar në kuadër të projektit.
- Të gjitha përfitueset duhet të plotësojnë kërkesat e aktivitetit, të bazuara në rezultate dhe në monitorim siç përshkruhet në thirrje.
- Aplikantët kanë dëshmi që me biznes idenë/planin nuk kanë konkuruar apo përfituar mjete të pakthyeshme nga një institucion në nivel nacional, lokal apo një donator tjetër për të njëjtat shpenzime (investime, operative, etj.).

<sup>1</sup> Pjesëmarrja në trajnime dëshmohet me listat e pjesëmarrjeve në programin e trajnimit nga MogUL dhe Code Partners.



This programme is funded  
by the European Union



**MNE-ALB**

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME  
MONTENEGRO – ALBANIA 2014–2020



Ministartvo  
regionalno-investicionog  
razvoja i saradnje sa  
nevladinim organizacijama

- Përfitueset e kualifikuara për financim do të monitorohen nga partneret zbatues të projektit (Komuna e Ulqinit dhe MoGUL në Malin e Zi dhe CODE Partners në Shqipëri).
- Aplikantët nuk duhet të jenë të përfshira në asnjë nga rastet që janë përshkruar në nenin 2.4 të PRAG (EU restrictive measures, exclusion criteria and rule of law conditionality)  
<https://wikis.ec.europa.eu/spaces/ExactExternalWiki/pages/152798613/2.+Basic+rules>

## **A.1 Kriteret e Pranueshmërisë për bizneset ekzistuese**

- Vetëm bizneset me bazë/seli në komunën e Ulqinit dhe rajonit e Qarkut Shkodër kanë të drejtë të aplikojnë.
- Konsiderohet aftësia për zbatimin e aktiviteteve brenda Zonës së Projektit.
- Nuk ka konflikte me palët e interesuara në fushat e zbatimit të biznesit planit.
- Është e/i regjistruar dhe funksionon sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi.<sup>2</sup>
- Propozimi për biznes ide/plan dorëzohet nga administratorja e biznesit.
- Aplikantët bashkë me planin e biznesit duhet të dorëzojnë NIPT-in e biznesit ose dokument tjetër që vërteton regjistrimin e aplikantës për veprimtarinë e vet afariste tek institucioni relevant.

## **A.2 Kriteret e Pranueshmërisë për bizneset e reja**

- Vetëm sipërmarrëset/bizneset që do të regjistrohen me bazë në Zonën e Projektit kanë të drejtë të aplikojnë.
- Konsiderohet aftësia për zbatimin e aktiviteteve brenda Zonës së Projektit.
- Nuk ka konflikte me palët e interesuara në fushat e zbatimit të aktiviteteve të projektit.
- Bizneset e reja duhet të punësojnë të paktën 1 person për një periudhë jo më pak se 6 muaj (vetpunësim).

## **3. KRITERET SPECIFIKE TË PRANUESHMËRISË**

### **Kushtet: (për renditje)**

- Bizneset ekzistuese si edhe bizneset e reja marrin pikë shtesë në renditje në rastet kur parashikojnë punësim edhe të 1 personi tjetër nga grupet vulnerabël, për të paktën 6 muaj.

<sup>2</sup> Për aplikueset në Mal të Zi vlejnë ligjet e Malit të Zi kurse për aplikueset në Shqipëri, ligjet e Shqipërisë.



This programme is funded  
by the European Union



**MNE-ALB**

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME  
MONTENEGRO – ALBANIA 2014–2020



Ministartvo  
regionalno-investicionog  
razvoja i saradnje sa  
nevladinim organizacijama

- Iniciativat e biznesit që parashikojnë promovimin e mobilitetit të fuqisë punëtore, prodhimeve dhe shërbimeve përtej kufirit.
- Fondi i kërkuar duhet të mbulojë 100% shpenzime nga lista e shpenzimeve të pranueshme sipas planit të biznesit të miratuar për secilen pëfituese.

### **Kushte shtesë: (për renditje)**

- Idetë/planet e biznesit stimulojnë zhvillimin dhe promovimin e turizmit rural dhe agro-turizmit.
- Idetë/planet e biznesit kontribuojnë në afirmimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe traditës. (veprimtari apo zanate që janë në rrezik zhdukjet)
- Idetë/planet e biznesit stimulojnë zhvillimin e bujqësisë dhe metodave të reja të prodhimit bujqësor/blegtoral.
- Idetë/planet e biznesit janë inovative.
- Idetë/planet e biznesit marrin parasysh ruajtjen e mjedisit jetësor dhe kriteret e zhvillimit të qëndrueshëm.

### **Politika e financimit**

- Përfitueset e granteve përfitojnë sasinë e mallrave dhe shërbimeve sic janë parashikuar në planin e tyre të biznesit, në përputhje me politikën e shkruar të programit IPA BNK MNE-ALB.
- Procedurat për blerjet e mallrave apo shërbimeve të parashikuara në planin e biznesit dhe miratuara me kontratë, kryhen nga Komuna e Ulqinit në Malin e Zi dhe CODE Partners në Shqipëri.
- Mallrat dhe produktet e përfituara në kuadër të kësaj thirrje/projekti, mbeten në përdorim të përfitueses deri në fund të afatit të projektit. Në mbyllje të projektit, dhurohen tek përfituesit me akt-dhurimi të nënshkruar ndërmjet AK dhe përfitueses së mbështetjes financiare.

## **4. SHPENZIMET E PRANUESHME**

Skema e mbështetjes financiare mund të ofrojë mbështetje për aktivitetet e mëposhtme, por pa u kufizuar në:

- Blerja e pajisjeve për nevoja të biznesit;
- Pasurimi i arkivës bibliografike;
- Promovimi i tureve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore për të mbështetur ekonominë lokale dhe për të ruajtur traditat kulturore. Aktivitetet ndërkufitare për promovim mund të mbështeten gjithashtu;



This programme is funded  
by the European Union



**MNE-ALB**

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME  
MONTENEGRO – ALBANIA 2014–2020



Ministarstvo  
regionalno-investicionog  
razvoja i saradnje sa  
nevladinim organizacijama

- Rregullimi/përmirësimi i kapaciteteve të objekteve akomoduese private pranë ofruesve të shërbimeve turistike/produkteve me bazë natyre (për rregullimin, pajisjen ose rinovimin e objektit sipas traditës);
- Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve turistike të bazuara në natyrë në zonat e mbrojtura;
- Dizajnimi dhe printimi i etiketave të reja për produktet e biznesit;

Kjo nuk është një listë shterruese. Disa aktivitete mund të konsiderohen të pranueshme nëse janë në përputhshmëri të plotë me qëllimet e projektit 'Women microenterprise development in the cross border area' dhe esenciale për veprimtarinë e sipërmarrëses.

## **5. SHPENZIMET E PAPRANUESHME**

- Blerja ose marrja me qira e tokës.
- Gjobat dhe dënimet e tjera monetare dhe shpenzimet gjyqësore.
- Kostot bankare, kostot e garancisë dhe kosto të tjera të ngjashme.
- Kostot e amortizimit e të mirëmbajtjes.
- Kostot që lidhen me kontratat e qirasë, të tilla si marzhi i qiradhënësit, shpenzimet e përgjithshme dhe kostot e sigurimit.
- Investimet në përpunim ose aktivitete të tjera që mund të rezultojnë në rritje të ndotjes së ambientit.
- Furnizimi me pesticide jo organike ose aktivitete që mund të kërkojnë përdorim shtesë të pesticideve
- Investimet në kompanitë të zotëruara nga shteti.
- Investimet në tokë që është e zënë ose e përdorur zyrtarisht ose joformalisht nga palët e treta, të cilat do të rezultojnë në zhvendosjen e tyre
- Investime që mund të kenë një ndikim negativ në habitatet natyrore të mbrojtura ose të rëndësishme, ekosistemet ose biodiversitetin.
- Humbje nga normat e këmbimit.
- Taksat (si kombëtare apo ato lokale).



This programme is funded  
by the European Union



**MNE-ALB**

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME  
MONTENEGRO – ALBANIA 2014–2020



Ministarstvo  
regionalno-investicionog  
razvoja i saradnje sa  
nevladinim organizacijama

## **6. MËNYRA E APLIKIMIT, AFATET DHE PROCEDURA**

Mbështetja e grave sipërmarrëse do të realizohet në dy faza:

- Faza e parë – Aplikim me ide biznesi/Koncepti për zhvillimin e planit të biznesit
- Faza e dytë – Konkurimi me planin e biznesit/Mbështetja dhe zbatimi

Projekti synon të ndajë fondin në mënyrë të barabartë ndërmjet planeve të biznesit që parashikojnë zgjerimin e aktivitetit dhe atyre Start-up. Megjithatë, vendimi për ndarjen e fondit do të bëhet në varësi të pikëzimit të planit të biznesit dhe renditjes përfundimtare.

### **FAZA E PARË**

#### **Aplikimet për mbështetje financiare me ide biznesi**

Aplikantët dërgojnë idetë e tyre të biznesit bazuar në kriteret dhe kushtet e thirrjes deri me datë 12 shkurt 2026 (2 javë). Procedura e aplikimit për mbështetje në këtë fazë është si më poshtë:

- Aplikantja paraqet kërkesën përmes formularit zyrtar të aplikimit (formulari 1) dhe modelin për konceptin e grantit në përputhje me masat e përshkruara në këtë manual.
- Aplikantja që dorëzon formularin e aplikimit është e detyruar të dorëzojë të gjitha dokumentet e nevojshme të paraqitura në formularin e aplikimit si dhe të përshkruara në Thirrjen për Aplikime.
- Për këtë program të mbështetjes financiare, strategjia është të mbështesë aktivitetet/planin e biznesit për një kohëzgjatje prej 6 muajsh.
- Fondet e siguruara për këtë mbështetje financiare shpërndahen përmes një thirrje publike për koncept ide që do të publikohet në media elektronike (faqet zyrtare të partnerëve).
- Aplikimet e përzgjedhura do të vazhdojnë të punojnë me ekspertë në zhvillimin e planeve të biznesit për aplikim/zhvillimin e planit të biznesit për fazën e dytë.



This programme is funded  
by the European Union



**MNE-ALB**

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME  
MONTENEGRO – ALBANIA 2014–2020



Ministarstvo  
regionalno-investicionog  
razvoja i saradnje sa  
nevladinim organizacijama

- Aplikantët e përzgjedhura në fazën e parë paraqesin kërkesën përmes formularit zyrtar të aplikimit (formulari 2 dhe 3) në përputhje me masat e përshkruara në këtë manual.
- Aplikantja që dorëzon formularet e aplikimit (formulari 2 dhe 3) është e detyruar të dorëzojë të gjitha dokumentet e nevojshme të paraqitura në formularin e aplikimit si dhe të përshkruara në thirrje.

## **Komisioni**

Vlerësimi i aplikimeve do të bëhet nga një komision i posaçëm që do të ngrihet nga stafi i projektit. Duhet të merren parasysh sa vijon:

- Idetë e biznesit me të cilat është konkuruar në përgjigje të thirrjes për grant, do të vlerësohen në bazë të kriterëve të shpallura paraprakisht, që përcaktojnë mënyrën e dhënies së mjeteve të pakthyeshme. Aplikimet që nuk përmbushin kërkesat e deklaruara në Thirrje, nuk do të merren parasysh në procesin e mëtejshëm.
- Anëtarët e komisionit vlerësues nuk mund të jenë në marrëdhënie hierarkike/vartëse me njëri-tjetrin.
- Mbledhjet e komisionit të vlerësimit të aplikimeve do të zhvillohen të mbyllura dhe anëtarët e tyre duhet të respektojnë konfidencialitetin.
- Nëse një aplikim plotëson kërkesat e pranueshmërisë dhe kriteret e ligjshmërisë, ai do të vlerësohet në bazë të kriterëve për dhënien e grantit.
- Nëse një aplikim konstatohet se nuk i plotëson kërkesat e pranueshmërisë ose kriteret e pranueshmërisë, ai do të refuzohet.
- Vlerësuesit duhet të kenë kompetencë teknike në fushën e thirrjes.
- Komisionit të Vlerësimit duhet t'i jepet kohë e mjaftueshme për të kryer vlerësimin si duhet dhe në përputhje me këto rregulla.

Procesi i vlerësimit planifikohet të realizohet në periudhën nga data 12-20 Shkurt 2026.

## **Raporti i vlerësimit**

- Kur aplikimet të jenë vlerësuar, hartohet raporti i vlerësimit.
- Raporti i vlerësimit do të përmbajë informacion mbi aplikimet, informacion mbi vlerësimin e kriterëve të pranueshmërisë dhe ligjshmërisë, vlerësimin e kriterëve të përzgjedhjes së idesë së biznesit dhe më pas dhënies së grantit dhe sipas rastit, renditjen e aplikimeve.

Shpallja publike e aplikanteve dhe informimi i tyre që kalojnë në fazën tjetër, planifikohet të bëhet deri me datë 28 Shkurt 2026.

## **Përgatitja e planeve të biznesit**

Për aplikantët e përzgjedhura në fazën e parë do të sigurohet shërbimi i ekspertit për hartimin e biznes planit. Të gjitha aplikantët e përzgjedhura kanë të drejtë të shfrytëzojnë këtë shërbim në një periudhë 1 muaj me orar të caktuar paraprakisht. Secila aplikante punon drejtpërdrejtë me ekspertin për biznes plane në hartimin e biznes planit të vet.



This programme is funded  
by the European Union



**MNE-ALB**

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME  
MONTENEGRO – ALBANIA 2014–2020



Ministarstvo  
regionalno-investicionog  
razvoja i saradnje sa  
nevladinim organizacijama

## **FAZA E DYTË**

### **Aplikimi me Plane Biznesi**

Aplikantet që kërkojnë mbështetje financiare, paraqesin planet e tyre të biznesit bazuar në kriteret dhe kushtet e thirrjes deri me datë 27 Mars 2026.

Procesi i aplikimit në këtë fazë është si më poshtë:

- Aplikantja e paraqet kërkesën përmes planit të biznesit të zhvilluar me mbështetjen e ekspertit
- Aplikantja e cila dorëzon aplikimin për mbështetje financiare për planin e biznesit, është e detyruar të dorëzojë të gjitha dokumentet e nevojshme siç janë përshkruar në Thirrjen për Aplikime.
- Për këtë program, strategjia është të mbështesë aktivitetet/planin e biznesit për një kohëzgjatje prej 6 muajsh.
- Fondet e siguruara nga programi i grantit të projektit shpërndahen përmes thirrjes që do publikohet në media elektronike (faqet zyrtare të partnerëve në projekt).

### **Komisioni i vlerësimit**

Vlerësimi i aplikimeve do të bëhet nga një komision i posaçëm që do të ngrihet nga stafi i projektit nga data 30.03-08.04 2026. Duhet të merren parasysh sa vijon:



This programme is funded  
by the European Union



**MNE-ALB**

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME  
MONTENEGRO – ALBANIA 2014–2020



Ministarstvo  
regionalno-investicionog  
razvoja i saradnje sa  
nevladinim organizacijama

- Aplikimet/Biznes Planet në përgjigje të Thirrjes për mbështetje do të vlerësohen në bazë të kriterëve të shpallura paraprakisht, që përcaktojnë mënyrën e dhënies së mbështetjes financiare. Aplikimet që nuk përmbushin kërkesat e deklaruara në Thirrje, nuk do të merren parasysh në procesin e mëtejshëm
- Komisioni i vlerësimit mund të kërkojë sqarime në lidhje me një aplikim/biznes plan, duke përfshirë dorëzimin e dokumentacionit shtesë mbështetës. Aplikimet që nuk ndjekin formatin e specifikuar pas njoftimit të sqarimit mund të mos merren parasysh në procesin e mëtejshëm për fazën e dytë.
- Anëtarët e komisionit vlerësues nuk mund të jenë në marrëdhënie hierarkike/vartëse me njëri-tjetrin..
- Mbledhjet e komisioneve të vlerësimit të aplikimeve do të zhvillohen të mbyllura dhe anëtarët e tyre duhet të respektojnë konfidencialitetin
- Nëse një aplikim plotëson kërkesat e pranueshmërisë dhe kriteret e ligjshmërisë, ai do të vlerësohet në bazë të kriterëve të dhënies.
- Nëse një aplikim konstatohet se nuk i plotëson kërkesat e pranueshmërisë ose kriteret e pranueshmërisë, ai do të refuzohet
- Vlerësuesit duhet të kenë kompetencë teknike në fushën e thirrjes.
- Komisionit të Vlerësimit duhet t'i jepet kohë e mjaftueshme për të kryer vlerësimin si duhet dhe në përputhje me këto rregulla.

## **Raporti i vlerësimit**

- Pas vlerësimit të Biznesplaneve, do të hartohet raporti i vlerësimit.
- Raporti i vlerësimit do të përmbajë informacion mbi biznes planet, informacion mbi vlerësimin e kriterëve të pranueshmërisë dhe ligjshmërisë, vlerësimin e kriterëve të dhënies së grantit, dhe sipas rastit, renditjen e aplikimeve.

Shpallja e fituesve planifikohet të bëhet me datë 10 Prill 2026.

## **7 AUTORIZIMI DHE PEZULLIMI I SHPENZIMEVE TË GRANTIT**

Mbështetja financiare administrohet nga Komuna e Ulqinit dhe MogUL në Mal të Zi dhe CODE Partners në Shqipëri. Të gjithë partnerët duhet të sigurojnë që:

- Mallrat/pajisjet, produktet apo shërbimet kryhen/merren në bazë të vendimit të miratuar-kontratës, dhe
- Kushtet e "dhënies në përdorim" dhe më pas "dhurimit" janë përmbushur.



This programme is funded  
by the European Union



**MNE-ALB**

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME  
MONTENEGRO – ALBANIA 2014–2020



Ministarstvo  
regionalno-investicionog  
razvoja i saradnje sa  
nevladinim organizacijama

Nëse vërehet se mallrat/pajisjet apo shërbimet nuk përdoren sipas marrëveshjes/kontratës me përfituesen e mbështetjes financiare, autoriteti kontraktues (Komuna e Ulqinit në Mal të Zi dhe Code Partners në Shqipëri) mund të pezullojë mbështetjen e mëtejshme derisa të merren masat korrigjuese.

Nëse AK përcakton se mallrat/pajisjet apo shërbimet janë keqpërdorur, përfitueses nuk do t'i dhurohen mallrat/pajisjet apo shërbimet dhe është e detyruar për të rikthyer çdo fond të keqpërdorur, në këtë rast të paguaj dëmshpërblimin për keqpërdorimin e bërë.

Dhënia në përdorim e mallrave/pajisjeve apo shërbimeve bëhet në përputhje me kushtet e kontratës.

Pas marrjes në përdorim, përfituesja plotëson dhe nënshkruan një formular të Konfirmimit të Pranimit.

Në përfundim të projektit, dhe pas verifikimit se cdo veprim është në përputhje me parashikimet e planit të biznesit dhe kontratës, AK dhe përfituesja e grantit nënshkruajnë Aktin e Dhurimit, me anë të të cilit pronësia e mallrave/pajisjeve apo produkteve të tjera, kalon tek përfituesja e grantit.

## **8. MONITORIMI DHE RAPORTIMI**

Secili prej partnerëve në vendet përkatëse do të jetë përgjegjës për monitorimin e granteve sipas projektit. Marrëveshja e Grantit i jep edhe SPT-së të programit IPA BNK MNE-ALB të drejtën për të monitoruar bashkë me konsorciumin e partnerëve zbatues të projektit, përdorimin e fondeve të ofruara për përfitueset e grantit. Si pjesë e procesit të monitorimit, Marrëveshjet individuale të Grantit do të parashikojnë që AK:

- Monitoron investimet e kryera sipas marrëveshjes së grantit dhe
- Monitoron performancën operacionale
- Monitorin përdorimin e mallrave/pajisjeve apo produkteve të planit të biznesit

## **9. LISTA E DOKUMENTEVE TË NEVOJSHME PËR APLIKIM**

Të gjithë aplikantët duhet të dorëzojnë një dosje të plotë aplikimi që përmban listën e mëposhtme të dokumentacionit:

Faza e parë

- Formulari i idesë së biznesit – për biznese të reja dhe ekzistuese.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit (ID/pasaportë) të aplikantes – për biznese të reja dhe ekzistuese
- Vërtetim nga QKR në Mal të Zi dhe Shqipëri – vetëm për bizneset ekzistuese.



This programme is funded  
by the European Union



**MNE-ALB**

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME  
MONTENEGRO – ALBANIA 2014–2020



Ministartvo  
regionalno-investicionog  
razvoja i saradnje sa  
nevladinim organizacijama

#### Faza e dytë

- Vërtetim nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit në momentin e aplikimit
- Vërtetim për tatimet e paguara për vitin e fundit fiskal (nga Zyra e Tatimeve) – për bizneset ekzistuese.
- Vërtetim nga gjykata që aplikuesja ose përfaqësuesja e saj ligjore nuk janë nën hetime, lëshuar jo më herët se 30 ditë përpara dorëzimit të formularit të aplikimit.
- Biznes Plani i zhvilluar duke përmbushur të gjitha elementet dhe kriteret e dhëna në thirrje.
- Deklaratën e nënshkruar si dëshmi që me biznes idenë/planin nuk ka konkuruar apo përfituar mjete të pakthyeshme nga një institucion në nivel nacional, lokal apo një donator tjetër për të njëjtat shpenzime (investime, operative, etj.).

## 10 KRITERET E RENDITJES

**Aplikimet që nuk janë përgatitur sipas standardeve të shpallura në thirrje do të refuzohen. Vetëm propozimet e kualifikuara do të kalojnë në procesin e renditjes**

### 1. Vlerësimi i Idesë së Biznesit:

|    | Kategoritë për vlerësim                                                                                                                                                                                      | Nota<br>Maksimale | Nota mesatare* |
|----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|----------------|
| 1. | <b>Qartësia e Idesë</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ideja është e shpjeguar qartë dhe kuptohet lehtë</li> <li>• Problemi dhe zgjidhja janë të përcaktuara saktë</li> </ul>                      | 10                | —              |
| 2. | <b>2. Relevanca e Problemit</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Problemi ekziston realisht në treg / komunitet</li> <li>• Ideja adreson një nevojë konkrete dhe aktuale</li> </ul>                  | 15                | —              |
| 3. | <b>Inovacioni dhe Originaliteti</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ideja është e re ose sjell një qasje ndryshe</li> <li>• Ka elemente inovative (produkt, shërbim, proces, teknologji)</li> </ul> | 15                | —              |
| 4. | <b>Grupi i Synuar i Qartë</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Klientët/grupi i synuar janë të përcaktuar mirë</li> <li>• Ideja i përshtatet nevojave të tyre</li> </ul>                             | 10                | —              |
| 5. | <b>Potenciali i Tregut</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekziston kërkesë për produktin/shërbimin</li> <li>• Tregu ka potencial rritjeje</li> </ul>                                               | 15                | —              |
| 6. | <b>Ekipi / Sipërmarrësi</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sipërmarrësi ka motivim dhe angazhim</li> <li>• Ka aftësi ose përvojë relevante (ose gatishmëri për të</li> </ul>                       | 9                 | —              |



This programme is funded  
by the European Union



**MNE-ALB**

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME  
MONTENEGRO – ALBANIA 2014–2020



Ministartvo  
regionalno-investicionog  
razvoja i saradnje sa  
nevladinim organizacijama

|    |                                                                                                                                                                                   |            |   |
|----|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|---|
|    | mësuar)                                                                                                                                                                           |            |   |
| 7. | <b>Qëndrueshmëria Afatgjatë</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ideja ka potencial për të vazhduar në kohë</li> <li>Nuk varet vetëm nga financime të përkohshme</li> </ul> | 10         | — |
| 8. | <b>Pjesëmarrja në aktivitetet / trajnimet e projektit</b>                                                                                                                         | 16         | — |
|    | <b>Nota perfundimtare</b>                                                                                                                                                         | <b>100</b> |   |

## 2. Tabela e Vleresimit per Planin e Biznesit:

|    | Kategoritë për vlerësim                                                                                                                                    | Nota maksimale | Nota mesatare* |
|----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|----------------|
| 1. | Lidhja e planit të biznesit rreth kriterëve të renditura në thirrje                                                                                        | 15             | —              |
| 2. | Plani i biznesit përfshin punësimin e personave nga territori i projektit                                                                                  | 15             | —              |
| 3. | Plani i biznesit siguron të gjithë informacionin e nevojshëm për të filluar / udhëhequr biznesin, kohëzgjatjen e tij dhe suksesin e biznesit në të ardhmen | 15             | —              |
| 4. | Plani i biznesit përmban elemente për qëndrueshmërinë financiare e idesë së biznesit                                                                       | 10             | —              |
| 5. | Aspekti inovativ i planit të biznesit                                                                                                                      | 10             | —              |
| 6. | Lidhja e planit të biznesit me aktivitetet dhe shpenzimet                                                                                                  | 15             | —              |
| 7. | Të dhënat e sipërmarrësit / shoqërisë (numri i të punësuarve, zhvillimi i kapaciteteve, rezultatet e arritura                                              | 10             | —              |
| 8. | Prezantimi i planit të biznesit (Pitching day)                                                                                                             | 10             | —              |
|    | <b>Nota përfundimtare</b>                                                                                                                                  | <b>100</b>     |                |

## 11. Afati dhe mënyra e dorëzimit

Aplikantët e interesuar në Komunën Ulqinit (MNE) duhet të dorëzojnë idenë e biznesit të tyre në versionin elektronik në adresën: [ipa@ul-gov.me](mailto:ipa@ul-gov.me) sipas afateve me poshte:



This programme is funded  
by the European Union



**MNE-ALB**

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME  
MONTENEGRO – ALBANIA 2014–2020



Ministartstvo  
regionalno-investicionog  
razvoja i saradnje sa  
nevladinim organizacijama

Aplikantët e interesuar në Qarkun e Shkodres (AL) duhet të dorëzojnë idenë e biznesit të tyre në versionin elektronik në adresën: [info@codepartners.org](mailto:info@codepartners.org), sipas afateve me poshte.

## 12 KALENDARI I AKTIVITETEVE

Kalendari indikativ i përgatitjes, përzgjedhjes, kontraktimit dhe zbatimit të planeve të biznesit, është si më poshtë:

| Nr | Aktiviteti                                    | Data                                                         | Partneri Përgjegjës                       |
|----|-----------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|
| 1  | Publikimi i thirrjes                          | 28.01.-<br>12.02.2026                                        | Komuna e Ulqinit, CODE Partners dhe MoGUL |
| 2  | Ditë informuese                               | 03.02.2026-CODE<br>03.02.2026-<br>Komuna e Ulqinit,<br>MogUL | Komuna e Ulqinit, CODE Partners dhe MoGUL |
| 3  | Vlerësimi I ideve të biznesit                 | 12.02-<br>20.02.2026                                         | Komuna e Ulqinit, CODE Partners dhe MoGUL |
| 4  | Shpallja e rezultatit                         | 23.02.2026                                                   | Komuna e Ulqinit, CODE Partners dhe MoGUL |
| 5  | Hartimi i planeve të biznesit                 | 24.02-24.03.2026                                             | Komuna e Ulqinit, CODE Partners dhe MoGUL |
| 6  | Dorëzimi i planeve të biznesit                | 27.03.2026                                                   | Komuna e Ulqinit, CODE Partners dhe MoGUL |
| 7  | Vlerësimi i planeve të biznesit               | 30.03.-08.04.<br>2026                                        | Komuna e Ulqinit, CODE Partners dhe MoGUL |
| 8  | Shpallja e fituesve                           | 10.04. 2026                                                  | Komuna e Ulqinit, CODE Partners dhe MoGUL |
| 9  | Kontraktimi i fituesve                        | 17.04. 2026                                                  | Komuna e Ulqinit, CODE Partners dhe MoGUL |
| 10 | Zbatimi i aktiviteteve të planeve të biznesit | 17.04.-17.10.<br>2026                                        | Komuna e Ulqinit, CODE Partners dhe MoGUL |
|    |                                               |                                                              |                                           |



This programme is funded  
by the European Union



**MNE-ALB**

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME  
MONTENEGRO – ALBANIA 2014–2020



Ministarstvo  
regionalno-investicionog  
razvoja i saradnje sa  
nevladinim organizacijama